



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 95

Prishtinë, më 28.2.2017, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Selvije Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj dhe Pal Lekaj.

**Munguan:** Albulena Haxhiu, Doruntinë Maloku, Valdete Bajrami dhe Milena Miliçević.

**Mbledhjen e kryesoi,** Selvije Halimi, nënkryetare e Komisionit.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Gresa Ramadani- praktikante; Basri Berisha- IAP; Argjend Zejnaj- GP/AAK; Agon Foniqi- Kosova Sot; Rita Spahiu dhe Mërgim Hoti- praktikantë; Beadin Syla- Kosova Press; Genc Jaha- KDI; Lumnije Murati- ZPRK dhe Sanije Berisha- OSBE.

**Nga stafi mbështetës:** Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Përgjigje në kërkesën e Gjykatës Kushtetuese lidhur me rastin KO-12/17, dt. 14 shkurt 2017;
3. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Përgjigje në kërkesën e Gjykatës Kushtetuese lidhur me rastin KO- 12/17, dt. 14 shkurt 2017**

**Kryesuesja** e njoftoi komisionin për rastin KO-12/17 dhe tha se grupi punues i ngarkuar për të përgatitur përgjigjen për Gjykatën Kushtetuese, në afatin e përcaktuar e ka hartuar përgjigjen dhe ftoi kryesuesin e grupit punues, z. Armend Zemaj, që të arsyetojë shkresën me komente për Gjykatën Kushtetuese.

**Armend Zemaj**, në cilësi të kryesuesit të grupit punues, i ngarkuar për të përgatitur komentet për Gjykatën Kushtetuese për rastin KO-12/17, para Komisionit sqaroi se, adresimi i shqetësimeve të Avokatit të Popullit, derisa projektligji ishte në fazën e amendamentimit nuk qëndron, pasi që raporti i avokatit nr. 239/2016, është adresuar në kutitë postare-personale të deputetëve: Lirije Kajtazi, Selvije Halimi, Albulena Haxhiu dhe Armend Zemaj. Ky adresim i avokatit nuk përkon me adresimin zyrtar, pasi që çdo shkresë që adresohet tek deputetët, me emër, cilësohet si adresim personal, kurse ato që adresohen tek komisionet e Kuvendit, hyjnë në rrugë zyrtare të shqyrtimit. Po ashtu, komisioni, më datën 21.3.2016, me qëllim të sensibilizimit të aktorëve relevantë në proces të shqyrtimit, ka mbajtur dëgjim publik, që të shohë qëllimin e propozuesit dhe reformën që adreson ky ligj. Në këtë dëgjim, u tha nga propozuesi se qëllimi kryesor ka të bëjë me reformimin në tërësi të fushës së kundërvajtjeve, si dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në shqiptimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që kanë të bëjnë me kundërvajtje. Sakaq, z. Zemaj tha se ky ligj, në fazat e shqyrtimit në nivel ministror, i është nënshtruar një konsultimi të gjerë nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, duke përfshirë në këtë proces aktorët profesionalë me institucione të pavarura, Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial, Gjykatën Supreme, ekspertë vendorë dhe ekspertë ndërkombëtarë, duke u nënvizuar se është në harmoni me direktivat e Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, z. Zemaj tha se është në mandatin e Kuvendit të miratojë projektligjet, sipas funksionit legjislativ, por, megjithatë, duke u bazuar në aspektin e praktikës parlamentare, në Kuvendin e Kosovës, shumica e ligjeve sponsorizohen nga ministrinë e linjës. Duke u nisur nga fakti se projektligjet kalojnë shumë procedura të filtrimit deri në shqyrtimin parlamentar. Pra, duke marrë për bazë faktin se komisionet parlamentare dhe Kuvendi, vlerësojnë se këto ministri të linjës, që më pas edhe merren me zbatimin e ligjit, e njohin më mirë qëllimin dhe natyrën e çështjeve të rregulluara me dispozitat përkatëse, nuk praktikojnë të ndërhyjnë në çështjet të cilat mund ta prishin qëllim apo teknikën e ligjit të caktuar. Ministrinë, si institucionet kryesore të degës ekzekutive, vlerësohet se kanë mandatin, kapacitetet, instrumentet për zbatimin e ligjeve. Po ashtu, edhe përvojën dhe identifikimin e çështjeve sesi duhet të rregullohet një fushë e caktuar për nga aspekti normativ edhe Qeveria konsiderohet si “trup i punës” i Kuvendit, që i është dhënë mandati për të qeverisur. Ky mandat përfshin edhe draftimin e projektligjeve të caktuara dhe Kuvendi vlerëson se Qeveria dhe ministrinë përkatëse kanë bërë zgjidhjen e duhur gjatë hartimit të projektligjeve dhe nuk praktikohet të ndryshojnë në themel dispozitat përkatëse. Kjo

logjikë ka karakterizuar edhe shqyrtimin e Ligjit për Kundërvajtje, tek nenet e konstatuara nga Avokati i Popullit, për të cilat ka vendosur masë të përkohshme Gjykata Kushtetuese.

Në fund, theksoi se grupi punues, duke ruajtur frymën e ligjit, ka vazhduar punën me aktorët e përfshirë në këtë proces dhe i ka propozuar komisionit për miratim të 32 amendamenteve, të cilat nuk e kanë ndryshuar përmbajtjen e ligjit në nenet e kontestuar në Gjykatën Kushtetuese. Pasi e arsyetoi, paraqiti për miratim dhe procedim të mëtejshëm përgjigjen, e cila duhet t'i adresohet Gjykatës Kushtetuese.

**Kryesuesja**, tha se shkresa i përmban të gjitha elementet që bien në fushëveprimin e komisionit. Po ashtu, dakordohet me shqetësimet, nëse ligjet kanë problem gjatë zbatimit, mirëpo Qeveria apo ministrinë përkatëse, para se t'i dërgojnë në Kuvend projektligjet, dhe për më tepër kur për herë të parë rregullohet një fushë e caktuar, siç është rasti me Ligjin për Kundërvajtje, do të ishte mirë që procedurat të kalohen më seriozisht në dëgjime publike dhe të merren mendimet e të gjithë aktorëve, në veçanti të zbatuesve të ligjit, në mënyrë që mos të ketë probleme gjatë fazës së zbatimit të ligjeve. Për zbatimin e legjislacionit duhet të kenë informacione të gjithë aktorët zbatues, duke pohuar se për shumicën e legjislacioneve nuk ka njohuri të mjaftueshme nga personat kompetentë në zbatimin e ligjit dhe aq më pak ka njohuri tek qytetarët, të cilët detyrohen të sillen sipas normave ligjore. Ky rast duhet të jetë drejt asaj që në momentin e krijimit të koncept-dokumenteve të draftimit të ligjit në fusha të caktuara, në të njëjtën kohë duhet që edhe sponsorët e ligjeve të japin informacione të mjaftueshme në medie dhe të punohet me grupe të caktuara të interesit, në mënyrë që sa më shumë qytetarët dhe mekanizmat zbatues të ligjit të informohen dhe të japin mendimet e tyre gjatë fazës së hartimit të ligjeve. Në fund, znj. Halimi theksoi se ne dërgojmë përgjigjen e komisionit në Gjykatën Kushtetuese dhe të shohim vendimin e Gjykatës Kushtetuese, por nëse është e nevojshme, ligji mund t'i kthehet Qeverisë, mirëpo edhe ne si deputetë mund t'i rishikojmë nenet kontestuese dhe të vazhdojmë më tej.

**Pal Lekaj**, tha se sa i përket shkresës, mendoj se është në rregull, por mendoj se është bukur herët të thuhet se nuk ka të drejtë Avokati i Popullit apo ta gjykojmë ne, se a ka apo s'ka të drejtë, sepse i mbetet Gjykatës Kushtetuese të shqyrtojë lëndën. Gjithashtu, z. Lekaj shprehu habi se si mund të ndodhë kjo, sepse zyrat ligjore, para se të procedojnë projektligjet, duhet të konsultojnë ligjet, në mënyrë që mos të kenë kundërshti njëra me tjetrën, andaj ne duhet të kemi kujdes, para se të miratohet një ligj.

**Kryesuesja**, tha se z. Zemaj nuk e ka kontestuar shkresën e Avokatit të Popullit, por mënyra se si i është adresuar deputetëve, sepse institucioni siç është Avokati i Popullit, e di rrugën zyrtare dhe mënyrën e adresimit të çështjeve nëpër komisione në Kuvend. Një ligj nuk është çështje personale e asnjë deputeti, qoftë edhe e Kryetarit të Kuvendit, por është çështje e mekanizmave që janë krijuar dhe funksionojnë brenda Kuvendit. Sido që të jetë, unë nuk e marrë si shqetësim personal as të komisionit, duke pohuar se është mirë që ka mekanizma për t'iu drejtuar, andaj e konsideroj një praktikë shumë të mirë, që ne të ballafaqohemi edhe si Kuvend, për të parë defektet gjatë punës së ligjeve, sepse kemi kolizion të ligjeve.

**Armend Zemaj**, sqaroi sipas shkresës së Avokatit të Popullit, midis tjerash, është thënë se komisioni nuk i ka marrë për bazë konstatimet tona, por kjo nuk qëndron, sepse Zyra e Avokatit të Popullit e ka dërguar shkresën në kutitë individuale të deputetëve, ashtu si e ceka më sipër, ndërsa tek pjesa e interpretimit të neneve, ne nuk kemi ndërhyrë fare. Në fund, z. Zemaj theksoi se i mbetet Gjykatës Kushtetuese, që ta thotë fjalën e vet.

**Agim Aliu**, tha se secili projektligj e ka një histori dhe kur e kemi parasysh historinë e këtij projektligji, duke pohuar se kanë qenë akterët që kanë marrë pjesë ose është dashur të marrin pjesë. Për një vit të tërë nuk ka pasur reagime, ndërsa pas një viti, ka reagim përmes dërgesave, që u sqarua nga deputeti Zemaj. Shqetësim im është se ajo që po instalohet përmes një praktike që po bëhet nga organizata të caktuara, me qëllim që ato të përvetësojnë ndërhyrjen, kjo nuk është mirë, sepse na ka ndodhur edhe në projektligje tjera, ku qëllimshëm është lënë të kalohet dhe më pastaj të ndërhyhet në ligj, duke iu lënë t'i atribuohet një organizate të caktuar. Si anëtar i grupit punues dhe si anëtar i komisionit, e kam parë vetëm në media z. Hilmi Jashari, kur ka reaguar dhe unë nuk kam pasur asnjë shkresë, asnjë adresim, dhe po ashtu, nuk ka qenë as në grup punues, duke e ditur se ai ka qenë një kohë të gjatë zëvendës i Avokatit të Popullit, që do të thotë se ai e njeh mirë punën e tij. Ky ligj është miratuar për herë të parë në Kuvendin e Kosovës dhe ne kemi qenë të vetëdijshëm që ky ligj mund të ketë probleme në zbatim, por nuk kam besuar që do të ketë problem me këto nene, sepse vetë fryma e këtij ligji ka qenë që të bëhet shkarkimi i volumit të punëve nëpër gjykata.

*Meqë nuk pati diskutime tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:*

### **P ë r f u n d i m**

T'i dërgohen Gjykatës Kushtetuese komentet e hartuara nga grupi punues lidhur me rastin KO-12/17, datë 14 shkurt 2017.

### **3. Të ndryshme**

Nuk pati ndonjë pikë për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 10:35.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryesuesja e Komisionit,

---

**Selvije Halimi**